

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

|         |                                                                                                                                                                                                       |
|---------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| TITULLI | Shpërthen në depoja e armëve në Bullgari, dyshime për sabotazh rus                                                                                                                                    |
| ADRESA  | <a href="https://lapsi.al/shperthen-ne-depoja-e-armeve-ne-bullgari-dyshime-per-sabotazh-rus-i1093532">https://lapsi.al/shperthen-ne-depoja-e-armeve-ne-bullgari-dyshime-per-sabotazh-rus-i1093532</a> |
| BURIMI  | <a href="https://lapsi.al">lapsi.al</a>                                                                                                                                                               |
| GJENDJA | online                                                                                                                                                                                                |

## KOHA


|                       |                                                                                                                                                           |
|-----------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| KAPUR NGA NE          | 12 shtator 2026, 07:27:38 UTC<br><i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>                            |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 12 shtator 2026, 07:27:15 UTC<br><i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i> |

## HASH-ET · SHA-256

|            |                                                                  |
|------------|------------------------------------------------------------------|
| PËRMBAJTJA | 2836de1c1405b62faa1a88522161e2f9b02e2e57dc4318facbc8ba8b4e254b8b |
| TEKSTI     | ac6497eb23a0cf81229fda6b69556be82178e0d4fdb6609d04edf09979e598a1 |
| PAMJA      | 7abe80c7946b30babee4522205b14d2b8aa5187be7f0ce5ad1c2f747fc88aae3 |

## ZINXHIRI I PROVËS

|               |                                                                                                 |
|---------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------|
| KJO HYRJE     | cf7eb2d40cc1d0f98cbc8605b9e971c2f94b125f17b721ceaf3e640b4f9fc9ab                                |
| E MËPARSHMJA  | —                                                                                               |
| RRËNJA MERKLE | dc5604a0ce755a9d5d1469028f4a381ac6ab98fd701943eb1bf00221ffe62cb2                                |
| ANKORIMI      | submitted — dërguar, ende pa bllok<br><i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i> |



## SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet, në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/cf7eb2d40cc1d0f98cbc8605b9e971c2f94b125f17b721ceaf3e640b4f9fc9ab>

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



# Shpërthen në depoja e armëve në Bullgari, dyshime për sabotazh rus



LAPSI.AL • 12 SEPTEMBER 2026



Një shpërthim ka shkaktuar zjarr në një depo armësh në Bullgarinë qendrore gjatë natës, pranë fshatit Tsareva Livada.

Autoritetet bëjnë me dije se nuk ka persona të lënduar, ndërsa flakët janë përhapur nga një magazinë në tjetrën.

Zjarri shpërtheu në një strukturë të menaxhuar nga kompania bullgare e armëve EMCO, sipas mediave lokale që cituan një zyrtar të kompanisë.

Guvernatorja e rajonit të Gabrovos, Kristina Sidorova, deklaroi gjatë orëve të para të së shtunës se zjarri ndodhej në zonën e magazinave të fabrikës dhe po përhapej në ndërtesat e tjera.

Incidenti është i dyti i këtij lloji në një objekt të lidhur me EMCO-n brenda pak javësh. Një shpërthim tjetër në një strukturë të kompanisë ishte raportuar edhe muajin e kaluar.

Deri tani, nuk është bërë e ditur shkaku i shpërthimit. Reuters raportoi se nuk arriti të kontaktonte menjëherë kompaninë EMCO për një koment mbi ngjarjen.

Kompania drejtohet nga tregtari bullgar i armëve Emilian Gebrev, i cili më herët është bërë objekt i akuzave për sulme ndaj pronave të tij nga agjentë rusë.

Në vitin 2024, autoritetet bullgare lëshuan urdhër-arreste për gjashtë shtetas rusë, të dyshuar për përfshirje në shpërthimet që shkatërruan depo armësh të EMCO-së. Sipas prokurorëve bullgarë, në këto depo ruheshin municione të destinuar për eksport në Ukrainë dhe Gjeorgji gjatë periudhës 2011–2020.

Prokuroria bullgare kishte deklaruar gjithashtu se ekzistonte një lidhje e mundshme mes shpërthimeve në depot e armëve në Bullgari, një tentative për helmimin e Emilian

## ide



Ortaku besprerë i Ron Yeffetit  
Andi Bushati



Insistimi tek krimi, arësyeja përse kryeministri Rama duhet të dorëhiqet  
Blendi Kajsiu

MOTITIRANA

24°C

KËMBIMIEURO

91.94

## aktuale

22:36

**PAMJET/ Mali i Zi nuk e lë karvanin e diasporës të futet në Shqipëri, i çon në Kosovë**

22:06



104 ditë në shesh/ Të shtunën pritet pjesëmarrje masive nga diaspora



**TIA dhe Vodafone sjellin teknologjinë Airbus në Tiranë**

Ndiqe Lapsin edhe në



Me interes nga publiku



Gebrevit në vitin 2015 dhe shpërthimeve të regjistruara në vitin 2014 në depot e municioneve në Republikën Çeke.

Rusia ka mohuar akuzat për përfshirje në këto incidente. Ndërkohë, autoritetet bullgare vijojnë të hetojnë rrethanat e shpërthimit të fundit.

## Të këshilluara



### Nga Al-Kaida te “ujqit e vetmuar” dhe IA: Si ndryshoi terrorizmi pas 11 shtatorit?

Farhad N. ishte vetëm disa muajsh kur, më 11 shtator 2001, terroristët e Al-Kaidës rrëmbyen avionë pasagjerësh dhe i pë...



### Pak para zgjedhjeve, Berlini u godit nga një sulm masiv kibernetik

Pak para zgjedhjeve për Parlamentin e Berlinit, grupi i hakerëve Rhysida vodhi të dhëna, shantazhoi Senatin e Berlinit dhe, pasi përp...



### Nafta prek 110 dollarë për fuçi, rriten shqetësimet për furnizimin



### Mijëra drita në qiellin e Nju Jorkut, përkujtohet 25-vjetori i sulmeve terroriste të 11 shtatorit

Rreth 3 mijë dronë kanë ndriçuar qiellin e New York-ut gjatë provave për ceremoninë përkujtimore të 25-vjetorit ...



### PAMJET/ Izraeli shkatërron tunelet e Hezbollahut, shkakton tërmet 4.1 ballë

Izraeli shkatërroi infrastrukturën nëntokësore që i përkiste lëvizjes pro-iraniane të Hezbollahut në Libanin jugor ...



### Spiunazh në favor të Iranit, dy të arrestuar në Londër

Dy persona janë arrestuar në Londër nën dyshimin se kanë ndihmuar një shërbim të huaj inteligjence në kuadër ...



### Nga arrestimi i Agasit te klani Balluku/ Pse Rama ndërroi ministrin e Brendshëm



(FOTO) Ky është hoteli në Santorini që frymëzoi vilën e Belinda Ballukut në Palasë



Dy email-et për vilën/ Porosia e Ballukut para se në letra të shfaqej Igli Tare



EKSKLUZIVE/ Vilat në Dhërmi dhe Palasë, gati kërkesa e dytë e SPAK për arrestimin e Belinda Ballukut



## Bie zjarr në një anije në Kinë, 20 viktima



## Trump "hape thesin", premtom 5 mijë dollarë për çdo amerikan nëse republikanët fitojnë zgjedhjet

Presidenti Donald Trump ka hyrë në fazën e fundit të fushatës për zgjedhjet e mesmandatit në SHBA me një premtim të...



## Skandal me "Call-Centerat" në Ukrainë, DW: Të përfshirë zyrtarë të Prokurorisë!

Autoritetet ukrainase kundër korrupsionit, NABU dhe SAPO, kanë nisur një aksion ndaj zyrtarëve të Prokurorisë së Përgji...



## Trump premtom 5 mijë dollarë për çdo të rritur amerikan nëse republikanët fitojnë Kongresin

Donald Trump ka premtuar një pagesë prej 5 mijë dollarësh për çdo të rritur amerikan, nëse republikanët fitojnë...

## Me sytë katër



16:47

## A po eksporton apo jo armë Shqipëria? Ministria e Mbrojtjes me dy versione (VIDEO)

Që pas publikimit të përgjimeve të mikut izraelit të Ramës, Ron Yeffet, me disa shtetas ukrainas që kërkonin të bl...



## "Plaka ime s'di pultin e TV dhe jo më e-Albania"/ Korreshi tallet në Komisionin e Ligjeve

21:56



## VIDEO/ Batutat e Ramës me Altin nga Peza: Ky nuk është socialist, por...

23:04



## SPORT

→ Të tjerë artikuj



## PAPARAZZI



### Tension në tapetin e kuq? Reagimi i Nicola Peltz ndaj Brooklyn Beckham bëhet viral

Brooklyn Beckham dhe bashkëshortja e tij, Nicola Peltz, janë bërë sërish pjesë e vëmendjes mediatike, pas një momenti t...



### Megan Thee Stallion flet për ndarjen nga Klay Thompson

21:27



### Travis Kelce flet për herë të parë për dasmën me Taylor Swift: "Ishte magjike"

21:24



### Misteri i James Bond-it të ri po merr fund? Skenaristi zbulon detajin e papritur

20:23



### Cassie Ventura shfaqet për herë të parë në tapetin e kuq pas gjyqit të Diddy-t

18:56

▼

Themelues  
Armand Shkullaku  
Andi Bushati

[Contact](#) [Privacy Policy](#) [Cookies](#)

Me dashuri nga  


Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.